

Ernest Koliqi lindi më 20 maj 1903, në qytetin e Shkodrës. U arsimua për letërsi në Padova të Italisë dhe përfundoi me rezultate të shkëlqyera duke mbrojtur tezën “Epika popullore shqiptare”. E kaloi gjithë jetën e tij profesionale duke u marrë me arsimin, si ministër apo profesor i albanologjisë në katedrën e gjuhës shqipe në Universitetin e Romës. Kaq shumë dukej se e dashuronte gjuhën shqipe, letërsinë, vlerat dhe të kaluarën tonë të lavdishme, sa iu përkushtua gjithë jetën, me qëllimin e vetëm për të zgjuar ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve e për të hapur shtigje të reja, që të nxirrnin prej errësirës e të udhëhiqnin drejt përparimit.

Ai njihet si një prej personaliteteve më të shquara të letrave shqipe dhe si **themelues i prozës moderne** të letërsisë sonë. Por, Koliqi nuk ishte thjesht një prozator. Ai ishte poet, dramaturg, publicist, filozof, psikolog, folklorist, gjuhëtar, mendimtar dhe të gjitha këto aftësi ndërdisiplinore shfaqen mjeshtërisht në çdo fletë të veprave të tij. E nuk kishte si të ndodhte ndryshe nga një shkodran i lindur në një familje qytetare, i shkolluar në perëndim, në kontakt me veprat e disa nga njerëzve më me influencë të shekullit dhe sigurisht me një shpirt të ndjeshëm poetik, me talent të theksuar artistik, si edhe me mendje të hapur.

Po përse cilësohet Ernest Koliqi si themeluesi i prozës moderne shqiptare? Çfarë e bën të ndryshme veprën e tij nga letërsia e deriatëhershme? Cilat janë risitë, që solli ai në letërsinë shqipe? Së pari, do të listoj tiparet që e bënë Koliqin nismëtar të prozës moderniste dhe më pas do t’i trajtoj në mënyrë të mëvetësishme.

Risitë që solli Ernest Koliqi në letërsinë shqipe:

- Përzierja e tradicionales, mitikes dhe modernes
- Misteri, befasia
- Epifanizmi
- Psikanaliza frejdiste, reflektimi
- Psiko-filozofia, dilemat
- Absurdi
- Ndërtimi i ri i raporteve të kohës
- Paralelizmi mes përshkrimit të mjedisit dhe mendimit e gjendjes shpirtërore
- Shumëkuptimësia, mesazhet e hapura, simbolet
- Universalizmi, metoda induktive
- Stili
- Përzierja e zhanereve

Përzierja e tradicionales, mitikes dhe modernes

Në veprën e Koliqi gjejmë një miksim të mitikes, tradicionales dhe modernes. Shpesh ai merr një motiv a një mesazh, që vjen nga mitologjia e lashtë (kryesisht ajo shqiptare), e vendos në baza tradicionale dhe e pasuron me elemente moderne. Kështu, krijohet një përzierje bestytënish, elementesh fantastike, përrallash, burimesh mitologjike, besimesh të përziera me ëndërrime, meditime, haluçinacione dhe shtresa nënvetëdijesh të personazheve, aq sa duket sikur kemi të bëjmë me një lloj **realizmi magjik** alla-koliqian, të vendosura në realitetin shqiptar të fillim shekullit të XX-të. Ky realizëm magjik do të duket më vonë edhe në disa nga veprat e shkrimtarëve të tjerë shqiptarë, si p.sh te “Pallati i ëndrrave” i Ismail Kadaresë, “Karpa” e nxënësit të tij Martin Camaj etj.

“**Nusja e mrekullueshme**” është tregimi i parë i vëllimit me tregime “Hija e maleve”. Koliqi merr një shtojzovallë nga mitologjia ilire me të gjithë sharmin e saj të jashtëzakonshëm dhe e shndërron në një nuse të mrekullueshme të protagonistit (Lekës). I shton këtij tregimi edhe magjinë, si një dukuri fantastike. Ai nuk harron të na japë edhe detaje nga tradita shkodrane, si ritet, shtëpitë, dasma, që sjellin vazhdimësinë në kohë të këtyre zakoneve dhe të vetë popullit iliro-shqiptar. Por, të gjitha këto ai i sjell vetëm si sfond, si shkaqe të mënyrës së të menduarit të personazhit kryesor, pasi synimi i vërtetë qëndron te shpjegimi i psikologjisë së tij, duke bërë psikanalizë sipas modelit freudist.

Në tregimin tjetër me titull “**Kânga e re**” të të njëjtit vëllim, burimi i mendimit duket sikur vjen nga mitologjia greke, nga miti i famshëm për forcën e madhe të artit e dashurisë “Orfeu dhe Euridika”. Ton Lasku ishte një muzikant, violinist, i cili në momentin që bie në dashuri me një vajzë, kthehet në një Orfe (gr. Këngëtar vetmitar). Dashuria e tij duket e pamundur, sepse ajo është e pasur, ai i varfër dhe për më tepër ajo si një vajzë e re s’mund të dalë nga shtëpia e saj me mure të larta, sepse nuk është e hijshme sipas zakoneve.

Por, ashtu sikurse melodia e harpës së Orfeut depërtoi deri në shpirtin e zymtë të Hadit dhe kaloi edhe dyert e ferrit, ashtu edhe *jona* e violinës së Tonit i kapërceu të gjitha muret dhe arriti deri te zemra e vajzës së adhurar prej tij. Dhe këtu autori na vjen me mesazhin se arti (muzika) lind dashurinë. Gjithashtu ‘kënga e re’ vjen si nevojë, si mënyrë zhvillimi për tu shkëputur nga e kaluara e errët dhe për të shkuar drejt një të ardhmeje të ndritur.

“**Kërcimtarja e Dukagjinit**” është një nga tregimet, ku bie më shumë në sy përdorimi i elementeve fantastike, me synimin për të pasqyruar atë ç’ka vërtetë dëshirojmë të jemi dhe mënyrën se si duhet të bëhemi, duke u frymëzuar nga e kaluara e lavdishme. Aq magjepsës e mbresëlënës është arti i të rrëfyerit e të përshkruarit të Koliqit, sa që na duket sikur kemi të bëjmë me një përrallë të vërtetë të ardhur që nga kohërat e mesjetës arbërore. Hasen elementet tipike të një përralle:

-**Hyrja**: “Paska qenë dikur..”

-**Përdorimi i numrave tradicional e simbolik në krijimtarinë gojore**: “Mbas një udhëtimi tri ditësh...”, “Kremtimi i madhnueshëm zgjati **shtatë** ditë e **shtatë** netë.”

-Personazhe nga mitologjia shqiptare: Zanat e malit

-Zgjidhja fantastike: Kërcimtarja e Dukagjinit ishte zëvendësuar nga Zânat e Dukagjinit.

“**Ândërr e një mbasditeje vere**” është, sipas mendimit tim, një nga visaret më të çmuara të Koliqit tregimtar. Kjo në rradhë të parë, për shkak të ndjesisë së mrekullueshme që të krijon ky tregim, kur e lexon. Atmosfera dhe gjithçka tjetër aty është e mbushur me magji.

“Ândërr e një mbasditeje vere” ngjahson me komedinë e William Shakespeare “**Ëndërr e një nate vere**” jo vetëm nga titulli. Te të dyja dallohen elementet fantastike. Te britaniku kemi një pyll të tërë të mbushur me zana dhe magji, kurse te Koliqi zhvillohet një bisedë e Netës me portretet e gjyshërve të vdekur, pra shpirtëzohen fotografitë. Te të dy autorët, e magjishmja shfaqet vetëm gjatë kohës së ëndërrimit në orët e fundit të ditës, deri në mesnatë.

Si përfundim, personazhet zgjohen të ndryshuar, sikur t’i ketë prekur magjia. Ata kanë ndryshuar mënyrën e të menduarit, këndvështrimin e ndjenjat. Tek U.Shekspir, dashurohet personi që ke urryer më parë. Ndërsa te shkodrani, Neta fillon të dojë e vlerësojë më shumë vendin e saj, ndërkohë që ka menduar, se atje s’kishte asgjë e cila mund t’ia vlente, si dhe kënaqësitë e vërteta mund t’i gjeje diku larg Shqipërisë.

Bestytnitë dhe personazhet mitologjike luajnë një rol të rëndësishëm edhe te tregimi “**Kur Orët lajmojnë**”. Dy kaçakë dëgjojnë shtatë të shtëna, që vijnë nga askundi dhe kujtojnë, se Orët i paralajmërojnë vdekjen njërit prej tyre brenda shtatë ditëve. Nga mitologjia e bjeshkëve sillen Orët, si personazhe imagjinare, që nuk shfaqen direkt në skenë, por ne njihemi me to vetëm nga fjalët dhe mendimet e personazheve.

“**Zâna e fundme**” duket edhe kjo si përrallë për nga elementet fantastike e mitologjike, që përmban, si zanat e mrekullueshme. Në këtë tregim kemi një qasje të ideve të autorit tonë me ato të arbëreshit Jeronim de Rada. Të dy besojnë se do të vij një njeri i madh, që do ta shpëtojë atdheun. Shkrimtari na vjen edhe me idenë e çmuar, se arti dhe shpirti lulëzojnë vetëm në liri.

“**Pasqyrat e Narçizit**” është një vëllim prozator me shtatë tregime, që paraqesin më së miri botën e brendshme shpirtërore të shkrimtarit. Që nga titulli kuptohet se frymëzimi është marrë nga miti i njohur i Narçizit, i cili u dashurua me pasqyrimin e tij. Miti kalon në plan të dytë, por e ruan kuptimin e tij simbol. Në të shtata tregimet, Koliqi është parë në shtatë sipërfaqe pasqyruese të ndryshme, në kohë të ndryshme të ditës dhe të jetës, të cilat i kanë krijuar impakte të ndryshme, duke u nisur që nga narçizizmi e deri në dëshirën e përsosjes së shpirtit.

Miti i Narçizit pasurohet me elemente nga përrallat e gojëdhënat, që djaloshi i ka dëgjuar prej Dadës, si Zanat apo personazhi i Floçkës së Pusit nga mitologjia shqiptare, tek “**Ujëti e pusit**”. Gjithashtu, shfaqen bestytnitë të “**Pasqyrë e vjetër shkodrane**”, lidhur me tersin që supozohet të të sjellë të shikuarit në pasqyrë natën.

Edhe pse jo aq dendur sa te dy vëllimet tregimtare të sipërpërmendura, fantastikja shfaqet edhe në vëllimin “Tregtar flamujsh”. Këtë mund ta vërejmë për shembull te novela e fundit “**Djepi i arit**”. E gjithë novela është e ndërtuar mbi bazën e fantazisë, së ëndërrimeve për diçka që nuk ekziston, e lashtësisë mistike të të parëve tanë.

“**Hânë gjaku**” është një tjetër tregim i po këtij vëllimi, që edhe pse përmban shumë elemente moderne, i shton universit të realizmit magjik të Koliqit një tjetër bestytni, që lidhet me hënën e cila përmban njolla gjaku në sipërfaqen e saj. Sipas bestytnisë, kjo hënë e gjakosur është paralajmëruese e luftës.

Misteri dhe befasia

Duke qenë se një pjesë e krijimtarisë së Ernest Koliqit është kaq e pasur me elemente të fantazuara, me shfaqje irreale të realitetit e me detaje fantastike, nuk ka se si të mungojë misteri, që na intrigon për të zbuluar të pabesueshmen. Kështu te “**Djepi i arit**”, ashtu si Hilush Vilza e Loro Shegori, ne jemi gjatë gjithë kohës në ankth, me veshët ngritur e plot kureshtje për të zbuluar misterin e thesarit të lashtë. Të njëjtën ndjenjë përjetojmë edhe te “**Nusja e mrekullueshme**” apo te “**Kërcimtarja e Dukagjinit**”.

Por deri këtu nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Nuk është Koliqi i pari, që sjell misterin e intrigën në veprën e tij. E veçanta qëndron jo te bota e përrallave, por tek universi i pafund njerëzor. *Qenia njerëzore koliqiane*, shqiptari intelektual e i emancipuar është i shqetësuar për realitetin, për botën shqiptare, për fatin e zhvillimit të vendit, për malësorët e shkodranët. Heronjtë e tij depërtojnë në *shtiqjet më të mistershme të mendjes njerëzore*. Është pikërisht njeriu, me të gjithë *kompleksitetin* e tij, me mënyrën si mendon e vepron, me analizën apo vetanalizën psikologjike, që na intrigon të heqim velin e misterit, për të zbuluar se çfarë fshihet përtej asaj, që duket. Pikërisht këtu qëndron *modernja*, të gjesh misterin te realja, e vërteta, e zakonshmja, e përditshmja.

Gjithashtu, takohemi shpesh edhe me **befasinë**. Në disa nga shkrimet e tij, hasim një ndodhi apo një shfaqje ndryshe nga sa e kemi parashikuar. Për shembull, te “**Bylbiat e Plepishtit**”, të dy miqtë nuk e presin që te shtëpia, ku kanë bujtur, të shfaqej rastësisht vajza, dora e së silës ju ishte ofruar të dyve dhe të dy e kishin refuzuar.

Befasia duket edhe në disa raste në *zgjidhjen e situatës*, që vjen si një **deux ex machina**. Në tregimin “**Ândërr e një mbasditeje vere**” vajza zgjohej çuditërisht me mendje të ndryshuar, vetëm nga një ëndërr, që ka parë. E njëjta gjë ndodh edhe në poemthin-dramatik “**Historia e Skânderbegut**”. Shqiptarët ndryshojnë mendim edhe pikëpamje, menjëherë pas të folurës së heroit tonë kombëtar. Kjo ndodh më së shumti për të treguar rrugën e duhur, që ne shqiptarët duhet të ndjekim.

Epifanizmi

Termi **epifani** përdoret nga shkrimtari James Joyce për të zbuluar momente të veçanta të përshkëndritjes së një kujtimi të papritur në mendjen e personazheve. Kjo përvojë e fshehur prej vitesh në kujtesë, del në sipërfaqe duke sjellë të gjitha hollësitë dhe emocionet, që lidhen me të. Edhe Koliqi vjen për herë të parë në letërsinë shqipe duke epifanizuar objekte të ndryshme, si: qielli, arkivoli, hëna, muri.

“A ta laçë?...” është tregimi i vëllimit “Tregtar flamujsh”. Në sipërfaqe duket sikur gjithçka shkon mirë: një grup miqsh, që bëjnë piknik në ajër të pastër dhe argëtohen. Por, Lec Gurrmolla me ndjesi të holla poetike e zëdhënë i ideve e ndjesive të autorit, ngacmohet edhe nga detajet më të imta, për tu zhytur thellë në detin e kujtimeve të tij.

Si fillim, është **qielli** ai që tërheq vëmendjen e Lecit. *Qielli i Shqipnisë* e shkëput atë nga realiteti dhe e çon në vise të largëta, në meditime për atdheun. Edhe në fund të tregimit, Leci përsëri ngacmohet nga një **arkivol** që sheh. Pikërisht ky objekt ia ndërron rrjedhën ngjarjes, i bën personazhet më të ndjeshëm, duket sikur ia ul ritmin e gëzimit e duke i vënë në mendime, i kujton se jeta nuk është një lojë aq e thjeshtë sa “a ta laçë?”.

“**Hënë gjaku**” është një tjetër tregim, ku shfaqet dukuria e epifanisë. Një çift i dashuruar është duke shëtitur natën vonë, buzë lumit. Sapo shohin në qiell, se hëna është e përgjakur, gjithçka ndryshon. Djaloshi kthehet pas në kohë (në mendimet e tij) në vitin 1911, në pragun e luftërave të mëdha (për Shqipërinë, Ballkanin, Europën e gjithë botën). Në fund të tregimit ata ia lëshojnë dorën njëri-tjetrit. Hëna pa u përfshirë në tregim, vetëm me manifestimin e saj, i ka bërë të kuptojnë se kanë pikëpamje të kundërta.

Edhe te “**Xhami i dritores s’ime**” nga “Pasqyrat e Narçizit” vërehet epifanizimi. Në këtë rast, sendi që epifanizohet është *nji copë muri*. Muri qëndron në vend, kurse autori fluturon në ëndërrime filozofike, për të depërtuar në thellësinë e kuptimit simbolik të tij.

Psikanaliza frojdiste, reflektimi

Ndikimi frojdist është ai, që i jep më së shumti vlerë zhvillimit të personazheve të veprave të autorit shkodran. Tamam ky tipar, që prurja më moderne, që i solli ai letërsisë shqipe të shekullit të kaluar. Koliqi, që kishte qenë në kontakt me veprat e hebreat të famshëm, babait të psikologjisë moderne, nuk kishte sesi të mos ishte i ndikuar prej tij, në krijimtarinë e vet artistike. Në këtë mënyrë, letërsia shqiptare u pasurua me dimensione të reja, preku edhe ajo modernizmin europian në kohën e duhur, jo ashtu si kishte ndodhur rëndom me rrymat e mëparshme letrare, që ndonjëherë mbërrinin te ne edhe dy shekuj me vonësë.

Koliqi shkrin në mënyrë të përsosur artin e letërsisë me shkencën e psikologjisë së personalitetit (frojdiste). Në shumë nga tregimet e tij, qëllimi kryesor është qenia njerëzore, kurse objekti analiza psikologjike e personazheve. Kështu krijohet një lloj e re e prozës artistike, që quhet **tregimi psikospektiv**, i cili lind **letërsinë e psikanalizës**.

“**Dramë e vogël**” dhe “**Ândërr e një mbasditeje vere**” janë dy tregime që ngjashojnë për nga trajtimi psikologjik i personazheve. Viktori tek e para dhe Neta tek e dyta, të dy janë të mërzhitur dhe kanë nevojë të rrinë *vetëm*. Tërheqja e tyre dhe *mbyllja në odë* nuk është gjë tjetër veçse *veçim* nga të tjerët, për të parë brenda tyre dhe për të *reflektuar*. Të dy luajnë në piano për të *shfryrë emocionet* negative dhe për të shprehur pjesën e tyre më të mirë. Kjo, sepse Viktorit duan t’i mësojnë matematikën, që të bëhet tregtar i zoti, ndërkohë që ai s’mundet, sepse është i tërhequr nga arti, muzika. Ndërsa Netën s’e lejojnë të shkojë me pushime, sepse është vajzë.

Kështu, të dy personazheve u mohoen dëshirat dhe ata i ndrydhnin brenda. Por në një moment të caktuar vetmie, të nxitur nga një objekt (pianoja), ata shpërthejnë. Janë po aq të vetëdijshëm, sa edhe të pavetëdijshëm. Koliqi thotë: “Depërtonte veçse një gjysmë drite”. Në momentin e parë, ata udhëhiqen nga **superegoja**, e cila i bënë më të vetëdijshëm e të kontrolluar. Por, grilat janë të mbyllura, drita e dobët, dhoma e errët. Këtu ata veprojnë sipas instikteve dhe janë nën drejtimin e **idit**.

Në mendjen e tyre shfaqet deti me dallgë të mëdha, i tërbuar. Ashtu dëshirojnë edhe ata të jenë kundrejt ‘padrejtësive’, që i bëhen dhe pengesave të mëdha, që i shfaqen për tu penguar realizimin e ëndrrave. Ashtu është dhe gjendja e tyre shpirtërore: e trazuar. Një detaj tjetër i rëndësishëm janë edhe pasqyrat e vendosura përballë njëra-tjetrës, që sipas ligjeve të pasqyrimin krijojnë një numër të pafundëm imazhesh të pasqyruara. Me këtë, autori do të na shprehë se sa i thellë dhe i pafundëm është universi njerëzor. Dhe mbi të gjitha, sado të përpiqemi ta njohim veten është e pamundur t’ia arrijmë plotësisht. Pyetja më e vështirë është “Kush jam unë?” Mjafton të dalësh përballë një pasqyre, e cila ka përballë një tjetër pasqyrë dhe atëherë do ta kuptosh se kjo pyetje e ka përgjigjen përtej infinitit.

Edhe tregimet **“Kumbulla përtej murit”** e **“Kopshti”** do t’i trajtoj në çift. Të dy protagonistët, Lec Gurrmolla e Shuku shëtisin në një kopësht, ku ka gjithfarë pemësh e lulesh e ku ngrihen në ajrë gjithfarë aromash të mrekullueshme. Kopshti më shumë se një mjedis real është një mjedis irreal, që ka të bëjë me nostaljinë e kujtimet e fëmijërisë, me shpirtin në moshën e lulëzimit të personazheve, me shtresat e dijes e nënvetëdijes, që lidhen me rrezet e diellit dhe hijet e pemëve.

Dija dhe nënvetëdija janë shtresuar në formën e një **palimpsesti**, ku ndodhitë më të reja vendosen sipër kujtimeve të vjetra, për t’i fshehur a për t’i fshirë ato. Të dy heronjve u lind dëshira për të gërrmuar thellë në kujtimet e tyre të shkuara, për të gjetur diçka, që i vjen e mjegullt dhe e pashpjegueshme për kohën e fëmijërisë. Leci kërkon atë nusen e re e të bukur, që rrinte te kopshti ngjitur me shtëpinë e nandajës, kurse Shuku kërkon atë vajzën, që kishte luajtur me të kur ishte i vogël dhe e kishte mbrojtur nga të gjithë. Atëherë ishin fëmijë dhe nuk kuptonin. Po tani?

Tashmë ishin dy djem të rritur dhe e kanë kuptuar se ajo që kishin përjetuar ishte njëloj **libido**-je, që kishte ardhur ndoshta si emocioni i parë mashkullor, si ndjesia e parë e shfaqjes së seksualitetit në fazën e parë të pubertetit të hershëm. Në fund të dy e mësojnë, se ku kanë përfunduar këto vajza. Leci, jo se priste ndonjë gjë prej saj, sepse e dinte që ajo tashmë ishte e plakur, por thjesht donte të kuptonte veten e tij, thjesht nuk e pengonte dot forcën tërheqëse të seksit të kundërt tashmë, që ishte në moshën e rinisë, si dhe nuk e ndalte dot kureshtjen për të zbuluar emocionin e tij të vërtetë. Ndërsa, Shuku duket të jetë më i zhgënjyer, pasi ajo, të cilën ai ishte duke e konsideruar dashuri dhe po vinte ta vërtetonte, në ishte e tillë, bëhet pluhur, kur mëson se kjo vajzë tashmë ishte nusja e kushëririt të tij.

Edhe te **“Hënë gjaku”** bie në sy përdorimi i shumë i detajeve psikologjike, për të depërtuar deri te mendja e djalit. Përshkallëzimi minimizues i vetëdijes, për të arritur deri te nënvetëdija, kujtimet e shkëputja nga realiteti sillen nëpërmjet detajeve shumë të arrira të Koliqit. Në

fillim, ai nis të murrmurijë, ngadalëson hapat, nuk i kushton shumë vëmendje fjalëve të vajzës. Ai shkëputet ngadalë nga realiteti, derisa bota e tij bëhet ajo e mendimit e nostalgjisë për kohën e fëmijërisë.

Një tjetër personazh, që vlen të përmendet është edhe Ndreka Batuçi i tregimit **“Rrokoll”**. Zhvillimet psikologjike të personazhit nisin me analizën e vetes dhe te veprimeve të tij. Vlerësimi i tij për veten është i prekur nga realiteti, pa hiperbolizime ose teprime. Mungesa e forcës dhe e vullnetit kanë të bëjnë me vetë karakterin e individit, por edhe mënyra sesi i përjetonte ai dështimet për mos tërheqjen nga vesi i të pirit e shtynin më shumë drejt pamundësisë për të gjetur guximin e duhur për t’ia dalë mbanë.

Ndreka ndodhet shumë larg realitetit, i ulur aty në në tryezën e vetmuar të kafenesë. Nën ndikimin e alkoolit, mendja e tij fillon të turbullohet, mendimet i ka të mjegullta. Ai ndjen sikur diçka po ia ngushton mendjen, është i trysnuar nga realiteti i zymtë, nuk ka ndonjë dritë shprese e ajër të pastër për të. Ndreka nën ndikimin e pijes është në një gjendje nënvetëdiije, që e shkëput edhe më nga përballja me realitetin dhe e zhyt në baltën e mjerimit të tij.

Dhe më tepër se kudo tjetër analiza psikologjike e personazheve shfaqet haptazi te vëllimi **“Pasqyrat e Narçizit”**. Madje, këtu ajo shndërrohet në një auto-analizë, sepse autori është vetë personazhi qëndror i të shtatë tregimeve. Ai bën një reflektim total, një meditim, një udhëtim njohjeje në psikologjinë e tij. Ernesti-personazh kalon nëpër rrugën e njohjes së vetvetes, nëpër shtigje të paditura më parë, në skuta të errësuar, në objekte të ndriçuar nga drita e diellit me një larmishmëri ngjyrash e nuancash, në ndjesi e mendime të pashpjegueshme. Ai është në kërkim të Pse?-së dhe Si?-së së gjithçkaje, është në kërkim për të zbuluar ndërtimin tërësor të njeriut, çdo shkak e arsye.

Gjithçka e shqetëson, e ngacmon dhe e prek poetin, që është i zhytur thellë në meditime, autorin që kalon sa nga vetëdija te nënvetëdija. Të gjitha janë të pashpjeguara tërësisht, çdo gjë është relative dhe ka një anë misterioze brenda saj. Në fund, në pamundësinë për të prekur te qenurit i gjithëdijshëm dhe perfekt, ai dëshiron ta shkëpusi shpirtin e tij nga trupi, që është një barrë e ngarkuar me vese të ndryshme, dhe të end i lirë në botën e amshimit.

Një moment reflektimi shumë i spikatur dallohet në novelën **“Prrue ne Dukagjin”**, ku ndërgjegjia e tij e kritikon vetveten:

Ah, Narçiz i pashpirt, plot kujdes vetëm për kënaqurinë tande, ti erdhe mbi këto male si në një muzë të gjallë për me argëtue shqiset tueja e me gjetë një burim kangësh të bukura. U mashtrova. Shpatet e lulëzueme, pyjet plot mistere të blerta, krojet kangatare janë suazë e mrekullueshme rreth një pikësynimi të mjeruem. Motra të tueja, vllazen të tuej vuejnë në këtë eden rrezesh, ujnash, erëzash. Ajo dritë lilash, që vezullon në agim me hare virgjinre mbi maje të guximshme e derdhet si lum i drishëshem lugjeve, vishtirsisht depërton nëpër kulla të errta, që kanë frangijat përdritore, ku në tym e në ajër të pandrruem gjallojnë këto banesa malesh. Jashtë, ajër i shëndetshëm plot amësim pishe, e lule të puthuna prej flladit; mbrendë, duhma frymësh të ndryshme, ku mbin fara e sëmundjeve.

Kështu më thonte një za i përmbrendshëm. Randonte mbi mue një barrë e padukshme.

- Po, mbasi pafuqia e vjershës sate nuk mundet me zbutë mjerimin e tyne, vuej me ta, poet.

qaj me ta.

Psiko-filozofia, dilemat

Koliqui nuk ishte i vetmi autor shqiptar, që i dha pjesës dërrmuese të veprës së tij thelb të theksuar filozofik. Edhe të tjerë para tij e kishin bërë këtë, madje që humanistët tanë, Pjetër Budi e Bogdani. Por filozofia e tij ishte e një tjetër lloji. Ajo nuk ishte, fjala vjen, si ajo e Naimit, që kishte influencë të madhe nga poetët e filozofët pers. Koliqui shpalos një **mozaik pikëpamjesh filozofike**, që nga ato të grekëve të lashtë, hinduistëve e deri tek ato më modernet.

Por, ai nuk mbetet vetëm këtu. E gjithë filozofia e tij vjen si një shpjegim i situatave të ndryshme psikologjike, si një e vërtetë e pashmangshme, që indikon mënyra të vepruari e të menduari. Ai e shikon atë në një këndvështrim të ri, të pandarë nga psikologjia dhe i ndërthur këto disiplina për të sjell një prurje të re mjeshtërore. Këtë prurje, unë do ta cilësoja tipike, kryesisht për vëllimin **“Pasqyrat e Narçizit”**.

Sipas psiko-filozofisë së tij, njeriu është vazhdimisht duke njohur vetveten, duke kërkuar thellë në arkën e mistereve të unit të tij. (nga **“Kroni i Bardhanjorvet”**)

U përkula me pi në curril të kronit edhe më doli vetja e pasqyrueme në ujë të lugut. Me atë gazhup në shtat, dukesh një njeri tjetër, i panjoftun. Larg ishin pasqyrat me suaza të arta të shtëpisë sime në qytet. Por isha unë e jo tjetër kush. Sytë veçse ndrinin tue qitun do shkëndia të mistershme. Sigurisht në fytyrën time aty përtriheshin tiparet e ndonjë stërgjyshi bari.

Te **“Prrue ne Dukagjin”** Narçizi ynë nuk pret shumë për të shprehur rebelimin e tij. Ai rebelohet për të panjohurën, rebelohet sepse ka kaq shumë për të mësuar përtej asaj që shohim dhe dimë. Këtu përafrohet me filozofinë e Sokratit- Vetëdija për pavetëdijen e vetes është kushti i parë i të nxënës. Ai thoshte “Di një gjë, që s’di asgjë”. Kështu edhe Narçizi ynë me mendime sokratike thotë:

Gjithësa herë shof nga dritaret e shtëpisë malet që mbyllin kah veri fushën e Shkodrës, ndiej thellësisht plogtin e palavdi të jetës sonë qytetare. Malet e e hedhta, shkëlqyese në kaltërim qiellor, më lëshojnë prej së nalti e prej së largu një thirrje plot premtime të mistershme. Nuk e dimë na të gjithë se përtej atyne ledheve kalaje së gjallë ruhen e pruhën tepricat e Iliris? Po atëherë pse nuk ngjitemi deri atje për me ia zbulue rranjët qenies sonë kombëtare, për me ia hulumtue tharmet brumit me të cilin jemi ngjeshun?

Me mesazhin e ngjashëm, se gjërat nuk janë ashtu si duken dhe se shpesh, gjërat që duam i kemi kaq afër, por nuk i vëmë re, Koliqui na vjen edhe tek **“E gjeti mbas shimshirit”**.

Në tregimin **“Një cuterr ne Helveti”** autori lëviz në periudha kohore ndërmjet muajve, nga marsi te prilli, ndoshta për të shprehur mendimin filozofik, se me kalimin e kohës, gjërat përmirësohen dhe njeriu në auto-psikanalizën e tij arrin të qartësohet.

Te rrëfimi filozofik “**Vala e detit**”, autori përdor **stilistikën hegeliane** me hipoteza, argumente, kundër-argumente dhe deduksion. Stilistika e dialogëve, tejçon përmes tekstit luftën e brendshme të vetëdijes me nënvetëdijen të narratorit për t’i dhënë një zgjidhje artistike kësaj proze.

“**Ujë e pusit**” është një rrëfim i pajisur me idenë **filozofike heraklitiane**. Sipas saj, *realiteti është në ndryshim të vazhdueshëm. Gjithçka lëviz dhe kalon nga një gjendje në një tjetër, pra ‘gjithçka rrjedh’*, sikurse ujrat në lumë, ku vet autori përmend Drinin, Semanin, Kirin, Matin etj. Ndryshimi sipas Heraklitit ndodh si rezultat i *luftës së të kundërtave*, pasi ky është thelbi i realitetit. Kështu dhe Koliqi e rrëfen prozën në dy të kundërta, të cilat janë bërë të tilla me vete rrjedhën. Këtu dallohet edhe një ngjashmëri me romancierin britanik Robert Goddard, i cili e përdor të njëjtën filozofi, ashtu sikurse edhe autori ynë.

Po tek i njëjti tregim, për të shpjeguar gjendjen e tij psikologjike e shpirtërore, Koliqi na vjen edhe me dy pikëpamje të tjera psiko-filozofike. Janë psikologjia dhe filozofia e autorit, që e bëjnë atë të shohë anën pozitive, duke krijuar kështu një përafrim me **idenë e lumturisë epikuriane**. Nje filozofi, sipas së cilës, *lumturia konsiston te kënaqësia, e cila krijohet nga ‘ataraksia’ –mungesa e turbullimeve në shpirt dhe ‘aponia’ - mungesa e dhimbjes*.

Largo zymnimet e lenë dritën e shpresës të derdhet nxituese në shpirtin tand prej syve të nuses Poezi, hirin e së cilës as zhgënjimet ma mizore as pakuptimi njerzor ma damtues nuk mujtën me cënue.

Gjithashtu, autori mbron edhe idenë filozofike, *se pa përjetuar dhimbjen nuk do të mund të kuptojmë vlerën e lumturisë*.

Mos e mbyt në hidhënin e përvojës hirin e poezisë që të falen Zanat zemërbardha. Kërkove vetveten tue rrah shtigjet e ashpra të jetës. Kërkesa e lumnisë të hodhi mbi vërrije parrizesh të gënjeshtërtata. Pa u rysun ndër gabime e mundime nuk arrihet prehja në limanin e qetë të Urtisë. Ti je pinjoll i një fisi të mjeruem.

Po këtu, Koliqi vjen si mbështetës i **doktrinës së mishërimit të Pitagorës**, ku sipas tij *shpirti për tu çliruar nga fajësit, mëkatet e pakënaqësitë duhet të kalojë nëpërmjet shumë shpirttrave*, pra është vdekja fizike ajo, që i ndodh shqiptarëve ndër breza, por ajo shpirtërore udhëton në një kohë të kufizuar vetëm nga realizimi i qëllimit dhe vetëm atëhere mund të prehet i qetë. Kjo ngjashon edhe me thelbin e **filozofisë hinduiste**. Dhe mbi një filozofi të tillë, Koliqi ngre dramën moderne “**Rrâjet lëvizin**”.

Kështu të gjitha këto mendime filozofike, të përziera me meditime psikologjike e të përballura me realitetin dhe mosnjohjen absolute të njeriut, krijojnë **dilema** të mëdha për personazhet, të cilave shpesh nuk u gjendet zgjidhja.

Absurdi

Pena e Koliqit është ndër të parat, që na sjell fillesat e absurdit në letërsinë tonë. Absurdi koliqian krijohet si pasojë e mospërputhjeve brenda qenies njerëzore, nga mentalitetet e pakuptimta e zakonet e prapambetura, që vijnë nga e shkuara dhe vendosen gabimisht në kohën e sotme, duke e penguar atë të zhvillohet.

Në tregimin “**Gjaku**”, Doda është një mësues, që propagandon zhvillimin, çrrënjosjen e veseve, si shpagimi e hakmarrja dhe rrënjosjen e virtyteve, si besa. Ai mendon se gjithçka duhet të fillojë nga edukimi, nga shkolla, ku nxënësit, çuditërisht, *së pari mësojnë nga sedra e krenaria, pastaj nga kureshtja e dëshira*. Doda niset si një misionar, kur thotë:

“A ka send mâ të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjellë qytetnimin një kombi zhytë në errsinën e padijes?” -

“Ai që kalon nëpër popull me hedhë farën për një jetë mâ të mirë, ai që e ndriçon me një dritë mâ të bukur tokën që na ushqen, ai që bân me ngadhnjye agimet në muzgun e pacaktuem të shpirtnave; shkurt: kush i difton popullit një udhë të re qytetnimi të vërtetë, âsht i denjë me qënë i nderuem si gjysmë perëndie.”

“Tashti e kupton vetë misionin e madhnueshëm që duhej të kryejë çdo shqiptar i kulturuem përgjithsisht e në mënyrë të veçantë, një mësues si unë.”

Po çfarë bën në fund ky misionar, ky intelektual, ky mësues, ky gjysmë-perëndi? Tragjikisht dhe në kundërshtim me parimet e bindjet e tij, ai prish ekuilibrin e jetës dhe ndërgjegjes, duke vrarë atë që i kishte vrarë vëllain. Ai nuk e ndryshi dot botën shqiptare. Hija e maleve shqiptare ishte më e fortë dhe e pashmangshme se çdo ide përparimtare. Doda nuk e shmangu dot të qenurit shqiptar (në sensin negativ). Edhe ai u bë një gjakmarrës, duke e humbur kështu misionin *mâ të mrekullueshëm në këtë botë*.

Dukje të absurdit ka edhe në tregimin “**Vëna shtatëvjeçare**”. I ati i Lecit duket kaq absurd në sytë e të birit. Atë e habit jashtë mase veprimi, që bën babai. Ndërkohë që ai duket si i gjithëpushtetshëm në shtëpinë e tij, ka shumë privilegje, familjarët madje, as nuk mund të hanë në tavolinë me të. Në momentin që i vijnë miq në shtëpi, ai pëson një transformim befasues për Lecin. Sillet krejt ndryshe nga ç’është në të vërtetë, madje atyre, ‘të huajve’ u ofron edhe verën shtatë vjeçare, që as do t’i kishte shkuar në mendje ta pinte me të birin.

Edhe tek “**Anmiku në shtëpi**” kemi një **paradoks** në mënyrën e të menduarit të Simon Rrokullit. Paradoksi në psikologjine e tij qëndron te fakti, që ai do t’i tuhajësohet botës, ndërkohë që në të njëjtën kohë kërkon të ketë vëmendjen e të gjithëve.

“**Vaji i qitun**” është një tjetër novelë, ku absurdi duket edhe më shumë. Madje, ky tregim ka një ngjashmëri të habitshme me romanin “I huaji” të Albert Camus. Në këtë novelë gjithçka nis thjesht, aq thjesht sa të risjell ndërmend nisjen e rrugëtimit të Mërsoit, pas marrjes së telegramit për vdekjen e nënës së tij. Dhe kjo novelë nis me një vdekje, me vdekjen e vëllait të Çintos, Kolën.

Në fillim të tregimit ndeshemi me atë, që në disiplinën e psikologjisë e quajmë ‘**inteligjenca emocionale**’. Inteligjenca emocionale është vetëndërgjegjësimi, ajo që në dijet normale dhe

jo profesionale, që kemi e cilësojmë si parandjenjë. Por çfarë lajmi mund të kishte tjetër një telegram, që vinte në një orë të pazakontë si ‘*orë të shtyme të natës*’ dhe që lidhej me dikë të sëmurë me polmonit?

Posa u morr vesht se fliste për Kolën e se ajo letër vinte prej Milanit, të gjithë patën përshtypjen e ftohtë edhe njerit të qartë se sëmundja e randë ishte eufemizëm...

Koliqi s’kërkon fjalë të bukura për të shprehur dhimbjen, ashtu sikurse Kamyja e zhvesh rrëfimin nga figuracioni letrar. Ai me një thjeshtësi arrin të shkruaj për gjithë ritet mortore, të cilat janë traditë për shqiptarët. Por, në gjithë këto përgatitje Çintja nuk bashkohet. Ai i shikon të pavlera. Për të, dhimbja është dhimbje, e ç’rëndësi ka nëse ai nuk do të veshë diçka të zezë?

Ai përsëri do e kishte brenda tij dhimbjen po aq të madhe. Ç’rëndësi kishin ngushëllimet nga njerëzit, kur më shumë se nga dhimbshuria, ai i cilësonte si njerëz që vinin për të gjetur gabimet e bëra në parapërgatitje? As Mërsoi ynë nuk derdh lot, por kjo nuk e bënë atë robotik e njeri pa ndjenja. Çintja është i përhumun në dhimbjen e tij. “Kishte ndezë makinalisht një cigare e s’dinte kah me ia mbajtë nëpër shtëpi e shka me bâ.” “Ai u çue e lau faqet. Makinalisht tue përsëritun gjestet e përditshme...”

Ai është i tëhuajësuar nga vetvetja, është një hap larg vetëdijes së tij, por më pas e shohim këtë tëhuajësim të shfaqet edhe kundrejt të tjerëve: “Ai iku në odë të vet. S’deshironte me ndigjue ngushëllimet e kurrkujt, e s’donte me pa kurrkënd.”

Ai rebelohet, por shohim një rebelim të përmbajtur që ndalon vetëm në konstatim, por nuk vepron; ndoshta, ndoshta sepse nuk e ka forcën ose ndoshta se Çintua bën atë që Mërsoi nuk arrinte të bënte: të fshihte tëhuajësimin e tij.

Ajo që ndodh me Çinton është ajo që ndodh me masën. Ai kalon në meditime e në kujtime për Kolën. Gjithashtu, çdokush në dhimbje i drejtohet Zotit, si forcë shpëtimi apo lehtësimi, qoftë ose jo besimtar. Dhe Çinto i drejtohet forcave të mbinatyrshme, ndonëse del qartazi, që ai nuk është besimtar. Këtu qëndron edhe absurdi: një ateist, që kërkon ndihmë nga Zoti. Ky moment na kujton bashkëkohësin e Koliqit, Migjenin, i cili dallohet në vepër për prirjet e tij ateiste, por në momentet e fundit e të dhimbshme kërkon mëshirë.

Fundi përshkohet nga nota ironie, të cilat ironizojnë disa zakone, që në fund të fundit të privojnë ndjenjat, të privojnë të jesh ti. Një traditë, e cila e ndalon nënën të shpreh dhimbjen me lot, sepse dikush tjetër, që ndoshta s’ka pasur as lidhje me personin e vdekur, di të qajë më hijshëm e me një zë më mjeshtëror. Ky është absurdi i Koliqit.

Çintja vuni re, se e ama midis rreshtit të grave, s'qante mâ. Kishte qa në heshtje pa pushue deri njathere. Tashti, ish rendi i të tjerave, që dridhnin zanin me mjeshtri.

Absurde është edhe bota shqiptare apo mentaliteti i prapambetur malësor në një kohë të re. Kështu në tregimin “**Te tre lisat**” zakonet më të këqija shqiptare qëndrojnë mbi gjithçka. Dashuria dënohet dhe konsiderohet e pavlerë përpara gjakmarrjes. Kurse te “**Se qofsh, pleqnofsh**” zakoni i maleve asht ma i fortë se dashunia atnore...

Ndërtimi i ri i raporteve të kohës

Si shkrimtar modern që është, Koliqi e sjell modernizmin e vet edhe në detajet më thelbësore të rrëfimit. Koha për të ka një vlerë të veçantë. Nuk ka shumë rëndësi, se çfarë kohe ekzakte ka tregimi. Ajo që përbën interes është mbivendosja e raporteve të kohës. Nga e tashmja kthehet në të shkuarën, me anë të **retrospektivës nostalgjike**, ndërkohë që kjo e shkuar vjen si një shpjegim i së sotmes a motivim i së ardhmes. Ndonjëherë kjo e shkuar vjen edhe me hijen e saj, për të penguar zhvillimin e së tashmes drejt së ardhmes dhe për ta ndalur atë në vend.

Përveç kësaj, ai përziën kohërat. Ngjarjet e tij zënë vend në Shqipërinë e shekulli të XX-të, por aty ka detaje të lashtësisë e antikitetit ilir, apo ndonjëherë vendosen në mesjetën arbërore. Ky miksim i shkon më së miri për shtat mesazheve, që dëshiron të transmetojë Koliqi. Kështu, tejkohësia e tij bëhet mbartëse e mesazheve universale të të gjitha kohërave.

Megjithatë, në disa vepra të veçanta Koliqi duket si **romantik**. I shqetësuar nga realiteti i atdheut të tij, ai evokon të kaluarën e lavdishme me qëllim që tu tregojë shqiptarëve, se cila është më e mira për të. Këtë e vërehim te “**Kërcimtarja e Dukagjinit**”, ku prozatori i vendos ngjarjet në *agimin e ditës mâ fatlume të kombit tonë, i asaj dite që mbaroi tepër shpejt me një perëndim të përgjakun tue lânë mbrapa natën e errët të një robnie shekujsh*.

Po i njëjti motiv dallohet te “**Historia e Skânderbegut**”. Po, ndoshta ngaqë ishte vepra e parë e poetit. Mbase këtu ka filluar shkëputja nga romantizmi te modernizmi.

Në tregimin “**Hânë gjaku**” kemi disa shfaqje të së shkuarës:

- ❖ E shkuara vjen të shpjegojë të tashmen e të motivojë të ardhmen.
- ❖ Më shumë se një histori luftërash, e shkuara është një identitet që përcillet mes vlerave, traditave, mallit, kujtimeve, nostalgjisë dhe nga i cili nuk shkëputemi dot.
- ❖ Nuk ka të ardhme pa të shkuarën

Po me arsyen e motivimit të së ardhmes, duke u mbështetur në vlerat tona të çmuara të së kaluarës, kemi një shfaqje të së shkuarës edhe në tregimin “**Ândërr e një mbasditeje vere**”.

Të shkuarën si identitet e evidentojmë edhe te “**Rrâjet lëvizin**” ose te “**Pasqyrat e Narçizit**”.

Kryesisht në vëllimin **“Hija e maleve”**, por jo vetëm, e shkuara vjen si një pengesë për të ardhmen. Nga vetë titulli-simbol (pjesa negative e kuptimit), kuptohet se kjo hije e këtyre maleve kaq të lartë, pra këto zakone të prapambetura e mentalitete të gabuara, që i kemi trashëguar nga e shkuara, na e pengojnë dritën e zhvillimit të së ardhmes.

Por, e shkuara te Koliqi shfaqet edhe në mënyra të tjera. Ajo vjen dendur nëpërmjet kujtimeve të fëmijërisë, si shpjegim i përjetimeve të së shkuarës në të sotmen. Novela më tipike e kësaj natyre është **“Kumbulla përtej murit”**.

Paralelizmi mes përshkrimit të mjedisit dhe mendimit e gjendjes shpirtërore

Ernest Koliqi realizon përshkrime të mrekullueshme: kopshtet, peisazhet, odat, dugajat, natyra, qielli etj. Ne magjepsemi kur lexojmë rradhët e përpiluara *mjeshtnisht* prej shkodranit. Por, e theksoj përsëri: Koliqi është modern. Si i tillë, ai nuk do t'i sillte kurrë përshkrimet vetëm për të na kënaqur shijet tona artistike e ndjesitë për të bukurën. Funkcioni dhe arsyeja kryesore e sjelljes së përshkrimeve të detajuara nga Koliqi është për të na dhënë një pamje të mendjes e shpirtit njerëzor. Duke dhënë përshkrimin e mjedisit, në paralelizëm me personalitetin e personazhit, autori e sjell këtë të fundit në një proces të vazhdueshëm zhvillimi.

Përshkrimi i kopshtit të Lec Gurmollës (**Kumbulla përtej murit**), Shukut (**Kopshti**), madje dhe i vetë Ernestit të **“Xhami i dritores s'ime”** nuk është gjë tjetër veçse një imazh shumëngjyrësh i botës së tyre të brendshme.

Po kështu, shiu, rrebeshi, stuhia, shtrëngata, vetëtimat, retë e zeza, bubullimat, era shkojnë më së miri me shpirtin dhe mendjen e trazuar të Dodës në tregimin **“Gjaku”**.

Edhe skutat e objektet e odës gjysmë të ndriçuar të Netës (**Ândërr e një mbasditeje vere**) e Torçit (**Dramë e vogël**) janë vetëm pasqyrim i psikologjisë së turbulluar të njeriut kompleks.

Në novelën **“Tregtar flamujsh”** Koliqi bën përshkrimin e dyqanit të Gaspër Tragaçit, me skuta të errëta, hedhurina, mallra të paorganizuara, dhoma pa ajrim për të na prezantuar më së miri me një njeri të zymtë, shpirtvogël, mendjengushtë e materialist.

Shumëkuptimësia, mesazhet e hapura, simbolet

Në kuadër të linjës simboliste, si pjesë e letërsisë moderne, Koliqi sjell një vepër, ku spikat shumëkuptimësia e simboleve dhe mesazheve, që për pasojë bëhen të hapura. Detajet vijnë me simbolika specifike, që lejojnë interpretime të ndryshme.

Hija e maleve-Në pamjen më sipërfaqësore njihemi me mjedisin, ku do të zënë vend ngjarjet: në relievin me klimën më alpine të Shqipërisë, në veri.

Në sensin negativ nënkupton prapambetjen, që vjen si pasojë e zakoneve të pakuptimta në kohën tonë dhe që pengojnë emancipimin e qytetarit dhe zhvillimin e ardhmërisë.

Në sensin pozitiv nënkupton krenarinë, qëndresën, vazhdimësinë e shqiptarizmit dhe vlerave tona më të mira.

Shpella (Kur Orët lajmojnë)-Është simbol i mbylljes në pjesët më të errëta, të largëta e të panjohura të vetvetes, largimi dhe fshehja nga të tjerët. Në të njëjtën kohë, si pjesë e mjedisit shqiptar vjen si identitet e vazhdimësi. Të parët tanë ishin pellazgët, që vjen nga fjala ‘shpellar’, pasi që jetonin në shpella.

Drita-Herë vjen si simbol i shpresës e herë si qartësi, vetëdije. Në tregimin “**Kur Orët lajmojnë**” shfaqet si simbol i frikës (edhe nga drita më e vogël e cigares) nga personazhet e zhytur në erresirë.

Hijet, errësira-Simbolizojnë nënvetëdijen, paqartësinë, moskuptimin, frikën, mosnjohjen, karakterin negativ (**Tregtar flamujsh**).

Deti-Është shprehje e lirisë, e lidhjes me botën (e qytetëruar), i mendjehapësisë, i ndjenjave të thella. Kurse **dallgët** e tij të tërbuara vijnë si gjendja e trazuar dhe e rebeluar shpirtërore dhe psikologjike.

Arti, muzika-Simbole të lirisë, dashurisë, shpirtit të virtytshëm. Gjithashtu, vijnë si vlerë e traditës sonë.

Kopshti-Përfaqëson botën e brendshme të personazheve, si dhe traditën e vjetër shkodrane për të ndërtuar kopshte të bukura me pemë të shumta e lule shumëngjyrëshe.

Muri-Simbol i pengesave drejt së dëshiruarës ose të panjohurës. Kurse te “**Kumbulla përtej murit**”, muri me ngjyrë të *papërçanësue*me përfaqëson ndërgjegjen e veshur me shtresa vesesh e mëkatesh.

Jasemini-Lule-simbol i dashurisë së pastër.

Reçeli-Përveçse tradita e amvisave shkodrane në plan sipërfaqësor, është realizimi i një procesi, tashmë të përfunduar.

Novelat e Koliqit sjellin mesazhe të shumta e të fuqishme, që i bëjnë njerëzit të reflektojnë e të vetëkorrigjohen, duke mësuar nga personazhet. Kjo realizohet nëpërmjet procesit të pastrimit të shpirtit të **katharsasit**, por që në rastin e Koliqit qëndron në nivele më të larta.

Ndodh kështu, sepse autori tregohet i kujdesshëm. Ai shpesh qëndron i paanshëm ose nuk i shpreh drejt për së drejti ndjenjat e mendimet e tij. Personazhet konfliktuon, debatojnë për pikëpamjet e tyre e ndonjëherë **konflikti mbetet i hapur**. Gjithsecili largohet, duke mbajtur të pandryshuar bindjen e tij. Ne na mbetet të arsyetojmë, të kalojmë në proces kuptimi e njohjeje e të zgjedhim alternativën, që qëndron më afër nesh.

Koliqi thjesht ofron realitetin haptazi, sipas mënyrës së tij. Por, si shkrimtar e intelektual ai di çfarë zgjedh. Merr ngjarjet më pikante e që e shqetësojnë më tepër dhe krijon vepra, që synojnë të na bëjnë më të vetëdijshëm e më pranë të vërtetës. Megjithatë, Koliqi kurrsesi nuk mund të qëndrojë tërësisht indiferent. Në qoftë se je i vëmendshëm e vigjilent, ndjehet një tis i hollë **ironie** shkodrane.

Edhe **mesazhet** e tij mund të interpretohen në shumë mënyra. Ato kuptohen sa nga pikëpamja atdhetare e lartësohen deri në nivelet e të kuptuarit të qenies njerëzore. Edhe e shkuara na vjen me mesazhet e saj të shumfishta, që ne i komentojmë në mënyra të larmishme sipas rastit.

Universalizmi, metoda induktive

Fuqia e mendimit të Koliqit është shumë e madhe. Shpesh, gjithçka nis nga një njeri, një individ dhe gradualisht shtrirja e kuptimit përhapet në formë rrezore, duke shkuar në infinit. Në këtë mënyrë, krijohet një lloj sistemi egocentrik në lidhje me njeriun. Qenia njerëzore qëndron në qendër të vëmendjes së autorit (**Humanizmi**); çdo gjë nis prej saj dhe më pas transmetohet te gjithçka që e rrethon. Nga kjo kuptohet, që autori preferon **metodën induktive** të trajtimit të subjektit. Pra, niset nga e veçanta për të shkuar tek e përgjithshmja. Kjo metodë e tij është shumë funksionale lidhur me përmasat **universale**, që Koliqi dëshiron t'i japi idesë së tij.

Si një ilustrim mund të shërbejë tregimi “**Hanë gjaku**”. Personazhet këtu nuk kanë emra. Ata janë thjesht **ai** dhe **ajo**. Identiteti i tyre nuk varet nga emri, sepse ata janë përfaqësues të diçkaje më të gjerë se dikush në veçanti. Janë përfaqësues të **psikologjisë së grupit**. **Ai**=*maskull* dhe nga ata njerëz, që e *vlerësojnë traditën*. **Ajo**=*femër* dhe pjesë e grupit të njerëzve, që duan *të shkëputen plotësisht nga e shkuara*. **Të dy**=*qytetarë, të shkolluar*.

Pra, ai merr dy personazhe nga *elita*, për të evidentuar rëndësinë e vlerave dhe zakoneve kombëtare. Vetë intelektualët janë **kontradiktorë**. Gjendja është kritike. Koliqi bën *apel qytetar*. Ne duhet të vendosim për më të mirën. Një situatë e ngjashme vjen edhe te “**Bylbylat e Plepshit**”. Megjithëse, këtu kemi të bëjmë me dy personazhe të njohur: Hilush Vilza dhe Loro Shegori. Kjo do të thotë se, autori i mëshon shumë idesë së ruajtjes së vlerave, identitetit, origjinës, duke qenë se pas Hilushit fshihet vetë Ernest Koliqi. Kështu, kuptojmë dhe se cilën anë të intelektualëve përfaqëson shkodrani.

Stili

Po përveç risive në aspektin e subjektit, kuptimit dhe trajtimit, Koliqi vjen si novator edhe për nga *stili i të shkruarit*. Autori ka një larmishmëri formash, që shkojnë përtej tradicionalesh. Në funksion të **imazhit** që dëshiron të krijojë dhe situatës, ai përdor fjali të shkurtra, pyetje filozofike, pyetje retorike, reticenca, ngadalëson ritmin, ecjen, e vendos gjithçka në heshtje, në mënyrë që vëmendja jonë të fokusohet vetëm në objektivin e duhur.

Mund të bëjmë një analogji mes tregimit “**Diloca**” dhe romanit amerikan “Flatrat e lirisë-Ditari i Koreit” për nga struktura e organizimit të tekstit. Tregimi është i ndarë në pjesë, që i përkasin ditëve të ndryshme dhe ngjashon me formën e një ditari të mbajtur nga Leci, për ecurinë e vazhdimësisë së Dilocës, e cila ashtu si Korei është arratisur për të gjetur **lirinë**. Te të dyja veprat fletët e ‘ditarit’ janë shumë *originale*: herë të shkurtra e pa subjekt, ndonjëherë mungojnë datat, shpesh ka vetëm ndjenja, copëra mendimesh, fjalë të shkëputura, dyshime, hamendësime dhe pjesët më të gjata mbartin ngjarjet kryesore. Po ndryshe nga Korei, këtu nuk e mban ditarin Diloca, personazhi për të cilin zhvillohet ngjarja, por dikush nga jashtë, mësuesi Lec.

E veçantë e stilit koliqian është edhe **reduktimi deri në eliminim i ngjarjes**. Koliqi është një narrator, por shumë nga tregimet e tij kanë pak ose aspak ngjarje. Pra, përveç kohës, ai e sjell modernitetin edhe në karakteristikën tjetër të prozës klasike, që është ngjarja. Kjo shfaqje e tij arrin kulmin në tregimin “**Kumbulla përtej murit**”. Këtu s’ka kurrëfarë ndodhie. Ka përshkrim, mendime, nostalgji e kujtime, por jo ngjarje.

Përzierja e zhanereve

Ernest Koliqi përpara faktit të të qenurit shkrimtar, prozator, gjuhëtar e i diplomuar për letërsi, është mbi të gjitha *poet*. Ndoshta për të, *poezia* nuk është dhe aq rezultat i shkollimit të tij, sesa është një dhunti e lindur, një talent a një dhuratë e trashëguar nga qyteti i artit e kulturës, Shkodra. Shpirti i tij i ndjeshëm prej poetit futet kudo, edhe te proza edhe te drama. Kështu duket sikur kemi një përzierje të zhanereve letrare dhe shkodrani na krijon forma të reja, si **proza poetike** ose **poema-dramatike**. E tillë është “**Historia e Skânderbegut**”, që autori e quan *poemth-dramatik*.

Ndërsa te novelat e tij, e gjejmë prozën poetike gjithandej. Koliqi nuk ngurron të shfaq **unin e tij lirik** dhe të ndalet shpesh në **ëndërrime e meditime poetike**.

*Humbi në një fluturim të vrikshëm mendimesh lyrike. I ndodhte shpesh me harrue shqimit vëndin ku gjindej e rrethin në të cilin rrinte, i joshun si nga një muzikë e hollë zgjue vrik në fund të shpirtit kah do largësina ajrore ku rasa mâ parandsí, e përshkueme nëpër shëndrita të deshirit poetik, merrte fytyrën e një arratije të mrekullueshme. I pau ata flámuj të shtjelluem në një dritë të gjallë fitoresh kumbore, në krye të një kombi të lir mbi udha plot brohorína t’ardhmenís kur era e larit tymonte e pastër drejt qiellit. I pau ato shqipe të zeza tue u lirue nga burgu i errët i një kohe të zezueme e tue rrahë flatrat nëpër ajrí të kuqe si engjuj drejtësie kah skâjet mâ të mshefuna të maleve e të fushave t’atdheut. “**Tregtar flamujsh**”*

Unë dashuroj lirinë që then çdo cak të padrejtë e çon, përtej mureve e përtej lumejve, në vllaznim me të panjoftunin e udhës që flet gjuhën time. Lumnia që ju kërkues pat një ritëm të ngathët e qe rrethue me një bukuri tepër vetmitare. Unë due ndjesitë e forta e të hapta që nxisin me ia hy veprimeve të guximshme, dashuroj lëvizjet përtrise, stuhit pastruese, luftat plot rrezik që nxjerrin nga fati me përdhuni agime ma të lume për të gjithë, adhuroj qiellat e

lira, shqipet fluturuese dhe theroret e përtrime majë maleve që kanë Zanat për priftnesha.
“Pasqyra e vjetër shkodrane”

Epilog

Vepra e Koliqit vlen të përmendet edhe për mendimin përparimtar e pikëpamjet emancipuese. Ka një respekt shumë të theksuar për femrën.

I dhashë fyellin e i thashë:

- Na, bjeri ti: unë s'dij me i ra...

Asaj iu shkim për pak të imta buzëqeshja te buza e më përgjegji:

- Vajzave, s'u ka hije me u ra fejvet e zamarevet!...

Unë e shikova, plot çudi. Disa vjet ma vonë në Dukagjin, mora vesht se ka male në Shqipëri ku zakoni urdhnon që grave mos t'u ndëgjohet zani ndër kangë veç kur përkundin kërthinin në djep a kur vajtojnë mbi një trup të vdekuni. “Kroni i Bardhanjorvet”

Kush nuk e din se një femër e bukur i ep shpirt pamjeve të natyrës? Edhe Dante në vetmin prendverore të parrizit të tokës, të cilin për me e përshkrue shkrini të gjitha ngjyrat, të gjithë tingujt muzikorë, të gjitha amshimet që në kujtim të fuqishëm ia kish grumbullue përvoja e shqiseve të stërholla, vuni si stoli të atij visi të mrekullueshëm një vashë që këndonte tue mbledhë lule, Matelden plot mister që s'dihet mirë shka shembëllen në poemë hyjnore. Por kjo Matelda ime arbënore s'erdh nëpër livadh të lulëzue tue vallëzue si ajo e Dantes me lule të purpurta e të verdha ndër duer, por u avit kah na, që rrinim në bar, kadalë, me hap të randë sepse barte në shpinë një ngarkicë drushë. “Prrue në Dukagjin”

Ai përdor një fjalor të kujdesshëm, të kulturuar, nuk ofendon, nuk shan e nuk përdor fjalë vulgare. E folmja e tij është një shkodranishte e pastër, e këndshme për veshin, e ëmbël e melodioze. Edhe Migjeni është i kujdesshëm dhe fjalori i tij është afër të folurës qytetare të përditshme. Por ka një dallim të madh mes tyre. Ashtu si është Lasgushi një poet pogradecar, që dallohet që në kontaktin e parë nga dialekti i pogradecit i personalizuar sipas stilit të tij, ashtu edhe Koliqi ka një gegërishte e shkodranishte, që e bënë atë **autentik** në atë çfarë shkruan.

Koliqi i solli shumë letërsisë shqiptare. Disa nga veçoritë janë tipike të tij, të tjera i huazon nga figurat më të shquara europiane (si migrimi i personazheve, i tipit balzakjan), disa i gjen në folklor, ia rrëmben traditës a realitetit dhe i thur në vepër me mjeshtërinë, që vetëm një artist i madh mund të bëjë.

Ernest Koliqi ishte shkrimtari, që zbuloi të vërtetat e mëdha të kohës së tij. Logjikish, si thotë edhe Konica, ai ka zbuluar të vërtetat e të gjitha kohërave. Kështu, ai meriton një vend nderi ndër më të mëdhenjtë e letrave shqipe...